



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 21.15.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË MINISTRISË SË DREJTËSISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit Shkëlqim Xhema dhe anëtarët e ekipit Leonora Hasani dhe Ajtene Llapashtica, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymberi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	27
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	28
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	31
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Si theksim të çështjes tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Për më gjerësiht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Ministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm me stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit - auditimi 2016**

Ministri ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë së Drejtësisë (MD) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

1. Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e pasurive fikse nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Në vijim kemi prezantuar çështjet e identifikuar:

- Në regjistrin kontabël të pasurive me vlerë mbi 1,000€, nuk ishte përfshirë projekti kapital “Krijimi i hapësirave në DML” në vlerë 65,330€. Kjo vlerë ishte realizuar në dy pagesa, mirëpo asnjëra prej tyre nuk është regjistruar. Si rrjedhojë regjistri kontabël i pasurive i shpalosur në PFV është i nënvlerësuar. Zyrtari i pasurive nuk ka arritur të identifikoj pagesat e projektit në fjalë. Ky projekt është regjistruar me vonë, në kohën kur ne e kemi identifikuar; dhe
- Pasuritë më vlerë nën vlerën 1,000€ janë regjistruar me vlerën blerëse duke mos e kalkuluar zhvlerësimin. Si rrjedhojë, vlera e tyre ishte e mbivlerësuar. Vlera e amortizimit/zhvlerësimit nuk është llogaritur dhe njohur prej vitit 2001 e deri më tani. Menaxhmenti kishte kërkuar nga zyrtarët e MF-së dhe MAP-it të intervenojnë në sistemin E-pasuria për të mundësuar zhvlerësimin, mirëpo kjo ende nuk është mundësuar². Ne kemi rekomanduar edhe në vitin paraprak për të përmirësuar regjistrat, mirëpo ky rekomandim nuk ishte zbatuar.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar për këto çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t’i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

² Përfshirë në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar e cila kishte regjistra të saktë të pasurisë.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria e Drejtësisë kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit , të datës 21/11/2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Në draft PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar. Pas sugjerimeve tona, MD ka bërë korrigjimet e nevojshme para finalizimit të PFV-e. Nga kjo vërehet se është i nevojshëm rishikimi sistematik i PFV-ve nga zyrtaret përgjegjës, për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe aplikimin e kërkesave të tjera për raportim.

Andaj bazuar në atë që u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

1.3 Rekomandimet

Për çështjet e theksuara të baza për opinion, japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë e detajuar për përcaktimin e shkaqeve për theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet dhe t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të tyre. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PFV-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MD-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MD lidhur me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. Raportimi ishte në nivel të duhur. Mënyrat dhe format e raportimit nga aspekti funksional-operativ janë të rregulluar edhe me ligjet e agjencie ekzekutive.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka realizuar nëntë (9) raporte të auditimit për menaxhmentin. Ato ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Megjithatë, edhe me tutje Shërbimi Korrektues i Kosovës nuk ka nxjerrë aktet ligjore për organizimin e brendshëm (organizimi, pozitat dhe vendet e punës).

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e MD-së për vitin 2015, ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime kryesore. MD ka përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dy (2) rekomandime janë zbatuar, një (1) është në proces dhe gjashtë (6) nuk janë zbatuar ende. Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i lartë

E gjetura MD ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015. Mirëpo pjesa më e madhe e rekomandimeve nuk janë zbatuar. Në këtë aspekt përveç planit të veprimit, kanë munguar veprimet e nevojshme nga menaxhmenti dhe personat përgjegjës.

Rekomandimet e pa zbatuara ndërlidhen me fushat, si: planifikimi dhe realizimi i buxhetit për projektet kapitale, mungesa e akteve ligjore për organizimin/sistematizimin e brendshëm në SHKK, realizimi i pagesave, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurive, menaxhimi i personelit si dhe raportimi i obligimeve të papaguara. Si pasojë e mos implementimit të rekomandimeve, dobësitë e njëjta vazhdojnë ta përcjellin ministrinë.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve lidhur buxhetin e projekteve kapitale, pagesat dhe obligimet, ekspozon ministrinë para dëmeve të mundshme financiare. Ndërsa, mos zbatimi i rekomandimeve tjera rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta, të cilat mund të ndikojnë në dobësi në menaxhimin financiar dhe të kontrolleve.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve është duke u monitoruar rregullisht dhe do të zbatohet në përputhje me afatet e përcaktuara kohore. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të saj. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MD-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo ka për qëllim mbështesë përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Pyetjet/komponentët e shqyrtuara janë si në vijim:

- “Ambienti i kontrollit”, menaxheret e njësive kanë qenë të përfshirë në diskutimet e planit të strategjisë, përfshirë edhe këshilltar ndërkombëtar. Ndërsa lidhur me koston e strategjisë ajo është në përputhje apo e mbështetur nga KASH (2014-2016) dhe e pasqyruar në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë;
- “Menaxhimi i rrezikut”, gjatë procesit të planifikimit të rrezikut janë marrë parasysh burime të jashtme dhe të brendshme. Në regjistër janë identifikuar rreziqet, përshkrimi i tyre, masat që do të ndërmerren dhe janë përcaktuar përgjegjësitë të secili departament;
- “Aktivitetet e kontrollit”, plani i prokurimit përgatitet në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore të miratuara. Pas miratimit të buxhetit, MD së bashku me Shërbimin Korrektues të Kosovës i përgatisin planet finale të prokurimit dhe të njëjtat i dërgojnë në Agjencinë Qendrorë të Prokurimit (AQP);
- “Informimi dhe komunikimi”, lidhur me raportimin në kohën e duhur për vendimmarrje, përgatiten raporte mujore, javore dhe sipas nevojë ditore; dhe
- “Aktivitetet e monitorimit”, sa i përket monitorimit lidhur me arritjen e objektivave dhe analizimin e shkaqeve për dështimet e mundshme, monitorohen në mënyrë rregullt në takimet e rregullta ku marrin pjesë ministri, sekretari i përgjithshëm, drejtorët e agjencive dhe menaxherët e njësive në kuadër të MD-së.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MD operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të MD-së veprojnë katër agjenci ekzekutive: Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) dhe Avokatura Shtetërore (ASH).

Agjencitë Ekzekutive kanë strukturën e tyre organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. Këto janë përgjegjëse për raportim, ku janë përcaktuar qartë si dhe janë aplikuar mënyrat dhe proceset e llogaridhënies dhe të raportimit. PFV-të e Agjencive dërgohen në MD, të cilat më pas konsolidohen dhe dërgohen në Thesar si një tërësi.

Agjencitë raportojnë rregullisht për aktivitetet e realizuara operationale dhe performancën e tyre, duke kontribuar në menaxhim financiar efektiv në nivel të ministrisë. Po ashtu MD shpenzimet javore i raporton në ueb faqen zyrtare të saj. Megjithatë do të tërheqim vëmendjen tek një çështje e cila mund të sjellë efekt negativ në këtë aspekt.

Çështja 3 - Mungesë e akteve nënligjore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ministri ende nuk kishte rregulluar me akte të veçanta organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e pozitave dhe vendeve të punës në SHKK dhe në institucione korrektuese. Kjo kërkohet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe duhet të përfshihen si kapitull i veçantë në rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës së Ministrisë.
- Për këtë çështje është rekomanduar vitin e kaluar, mirëpo përkundër përfshirjes në planin e veprimit ende nuk është zbatuar. Mungesa e aprovimit të akteve ligjore reflektohet te kapitulli 3.3.2 Paga dhe mëditje.
- Rreziku** Mungesa e akteve nënligjore të cilat e përcaktojnë organizimin e brendshëm krijon vakum në organizimin, sistematizimin dhe rregullimin e marrëdhënies së punës.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurohet se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për të adresuar rekomandimin e dhënë, për të nxjerrë akte nënligjore të cilat e rregullojnë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në SHKK.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

NjAB operon me tre (3) anëtarë - Drejtori i NjAB-së dhe dy (2) auditor. Për një auditim efektiv nevojitet program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja efektive e Komitetit të Auditimit (KA).

NjAB ka hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë paraparë nëntë (9) auditime gjatë vitit 2016, me fokus në fushat që paraqesin rrezik më të lartë. Kjo njësi ka përmbushur në tërësi planifikimin.

Në këto raporte, NjAB ka dhënë 30 rekomandime konkrete lidhur me përmirësimin dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm. Prej tyre 21 janë zbatuar, pesë (5) janë zbatuar pjesërisht, ndërsa katër (4) nuk janë zbatuar.

KA ka mbajtur katër (4) takime të rregullta në të cilat janë shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së si dhe kanë diskutuar për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MD në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Në vitin 2016, MD ka përdorur 99% të buxhet final, më një përmirësim për 3% në raport me vitin paraprak, megjithëse në këtë përqindje kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund të vitit.

Menaxhimi dhe raportimi i të hyrave është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin si dhe realizimi i procedurave të prokurimit publik ishte në përputhje me rregullat e përcaktuara për prokurimin publik. Në disa raste SHKK kishin aplikuar penalet duke ndëshkuar operatorët ekonomik për vonesat në realizimin e projekteve kapitale.

Megjithëse, veprime shtesë nevojiten në procesimin e lëndëve për pagesë dhe në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë. Në disa raste pranimi i mallrave dhe shërbimeve ishte bërë në mungesë të zotimit të mjeteve, si dhe kishte vonesa të shumta në procesimin e pagesave.

Më tutje MD, ka vazhduar me ushtrues detyre për periudha më të gjatë se tre muaj, ndërsa punësimet me marrëveshje të veçanta kanë tejkaluar afatet e lejuara. Te menaxhimi i pasurisë dhe obligimeve të papaguara nevojiten veprime shtesë për të përmirësuar menaxhimin dhe raportimin e tyre.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	-	59,315	201,863	349,455	74,257
Totali	-	59,315	201,863	349,455	74,257

Të hyrat e arkëtuara në vitin 2016 janë 201,863€. Prej tyre 59,315€ janë lejuar të shpenzohen për nevojat e MD-së, prej të cilave janë shpenzuar 51,224€. Pjesa e mbetur e të hyrave janë transferuar në Buxhetin e Kosovës (BK).

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	18,974,376	18,783,549	18,671,373	18,282,610	17,283,535
Granti i Qeverisë -Buxheti	18,926,176	18,243,631	18,167,651	18,223,247	17,090,890
Të hyrat vetjake ⁴	48,200	59,315	51,224	28,490	68,412
Donacionet e jashtme	-	480,604	452,498	30,873	124,233

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 303,003€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, MD-ja ka përdorur 99% të buxhet final ose 18,671,373€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, realizimi i buxhetit për investime kapitale mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet.

³ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	18,974,376	18,783,549	18,671,373	18,282,610	17,283,535
Pagat dhe Mëditjet	12,327,358	12,334,313	12,258,365	11,989,837	11,116,192
Mallrat dhe Shërbimet	4,657,349	4,782,358	4,750,087	4,497,472	4,479,657
Shërbimet komunale	922,169	971,866	968,009	1,051,136	1,048,553
Subvencionet dhe Transferet	-	9,900	9,900	-	2,781
Investimet Kapitale	1,067,500	685,112	685,012	744,165	636,352

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në raport me buxhetin fillestar, buxheti final për paga dhe mëditje është rrit për 6,955€. Fillimisht ishte rritur për 59,357€ (me rishikim të buxhetit 41,807€, pastaj me vendim të Qeverisë për 17,550€), mirëpo më pas si rezultat i kursimeve buxhetore ishte reduktuar për 52,402€;
- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti final ishte rrit për 125,009€. Fillimisht, me rishikim ishte reduktuar për 168,920€, mirëpo me pas ishte rrit për 480,604€ si rezultat i pranimit të donacioneve. Ndërsa në fund të vitit me vendim të Qeverisë kishte shkurtim për 186,675€;
- Buxheti final për komunalitë ishte rrit për 49,697€. Fillimisht kishte rritje me rishikim të buxhetit për 55,000€, pastaj një rritje prej 22,897€ përmes transfereve nga kategoritë tjera, ndërsa në fund të vitit me vendim të Qeverisë është shkurtuar për 28,200€;
- Me buxhetin fillestar MD-së, nuk i ishte ndarë buxhet për subvencione, mirëpo më pas me rishikim të buxhetit ju kanë ndarë 9,900€; dhe
- Buxheti final i investimeve kapitale ishte reduktuar për 382,388€. Fillimisht me rishikim të buxhetit ishte reduktuar për 307,844€, ndërsa me pas përmes transfereve në kategori tjera ishte reduktuar për 44,858€ dhe në fund të vitit me vendim të Qeverisë ishte reduktuar edhe për 29,686€.

Çështja 4 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura Realizimin e buxhetit për investime kapitale mbetet sfidë me të cilën përballet në vazhdimësi MD-ja. Buxheti final për investime kapitale është realizuar afro 100%. Megjithatë nëse i shohim lëvizjet e buxhetit në këtë kategori në mes të buxhetit fillestar dhe atij final, shohim se kjo kategori nuk ishte menaxhuar sipas planit të rrjedhjes së parasë. Si rrjedhojë e mos shpenzimit të buxhetit, kjo kategori ishte reduktuar për 409,388€. Kjo çështje ishte trajtuar në raportet e auditimit të viteve paraprake, mirëpo ende nuk është adresuar nga menaxhmenti.

Për me tepër, rreth gjysma e buxhetit, ose 44% ishte shpenzuar vetëm në tremujorin e fundit. Arsyet e mos shpenzimeve sipas planit të rrjedhjes së parasë përfshijnë vonesat në iniciimin e procedurave të prokurimit, anulimet si dhe periudha e realizimit të punëve.

Rreziku Ekzekutimi i dobët i buxhetit, do të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve të MD-së. Në anën tjetër niveli i lartë i shpenzimeve kapitale në fund të vitit rrezikon që pagesat t'i shmangen kontrolleve të duhura të procesit të ekzekutimit.

Rekomandimi 4 Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit/realizimit të buxhetit. Po ashtu, duhet siguruar se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.

3.1.1 Të hyrat dhe depozitat (fondet në mirëbesim)

Të hyrat e realizuara nga MD në 2016 ishin në vlerë 201,863€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga shitja e pasurisë së konfiskuar dhe të hyrat nga organizimi i provimeve (notari, jurisprudence dhe përmbarues privat etj.)

MD menaxhon edhe me paratë e të burgosurve dhe të hyrat e sekuestruara të cilat njihen si Fondi i Mirëbesimit. Brenda vitit 2016, pranimet e parasë në llogari të thesarit për SHKK-në dhe AAPSK-në ishin 1,441,408€.

Çështja 5 - Depozitat bankare - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ligji mbi sanksionet penale dhe rregulla financiare 09/2012 për fondet në mirëbesim, e përcaktojnë që sendet personale dhe paraja e të burgosurve do t'i kthehen të burgosurit pas lirimit të tij.
- Ne kemi vërejtur që vlera prej 25,644€ janë para që nuk ju janë kthyer të burgosurve pas lirimit të tyre. Vetëm në Qendrën Korrektuese të Dubravës në fund të vitit 2016 vlera e mjeteve të pakthyera ishte 13,844€.
- Sipas zyrtarëve përkatës, disa prej të burgosurve, pas lirimit nuk janë interesuar për mjetet të cilat ju kanë mbetur vite me radhë. Por kthimi i mjeteve në llogari të të burgosurve është përgjegjësi e SHKK-së.
- Rreziku** Mbajtja e parasë së të burgosurve të cilët përfundojnë dënimet është në mos pajtim me ligjet e aplikueshme dhe rritë mundësinë që paratë e tilla t'i ekspozohen keqpërdorimit.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj monitorim të rregullt të kësaj llogarie/depozitave nga zyrtarët përgjegjës, dhe kthimin me kohë të mjeteve për secilin të burgosur me rastin e përfundimit të dënimeve.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar Kontrolllet kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e MD-së. Në këtë kategori janë shpenzuar 99% të buxhetit final (ref: tabela nr.3).

Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi në çështjet e paraqitura në vijim:

Çështja 6 - Plotësimi i pozitave me ushtrues detyrë më gjatë se tre muaj - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas Ligjit të Shërbimit civil, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj. Ndërsa, emërimi i drejtpërdrejtë në pozita të lira, në kundërshtim me parimin e meritës, nuk është i lejuar.

Nga 20 dosjet e testuara në MD dhe SHKK ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Në Zyrën Qendrore të SHKK-së, në vitin 2016 në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit për Operativë, Siguri dhe Transportim të të Burgosurve është caktuar si UD, zyrtari i cili njëherit ishte UD Udhëheqës për Siguri që nga data 01.03.2013, për më tepër se tri (3) vite;
- Zv. Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë (QPM), është caktuar UD i pozitës së Drejtorit të QPM-së nga data 06.01.2016; dhe
- Në Qendrën Korrektuese në Prizren për pozitën e lirë të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit me 24.03.2016, është caktuar UD një Zyrtar Korrektues, i cili ishte UD i koordinatorit për ankesa të burgosurve.

Mbulimi i pozitave me UD, në SHKK nuk ishte në përputhje me ligjin e shërbimit civil. Për me tepër, janë caktuar nga një pozitë në tjetrën, duke kaluar edhe nga katër (4) koeficient që janë në kundërshtim me ligjet përkatëse.

Po ashtu në katër tjera është vërejtur se ne dosje mungonin raportet për vlerësimin e performancës.

Rreziku Avancimi, përkatësisht praktika e mbulimit të pozitave kyçe me UD më tepër se tre muaj rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo ndikon negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi. Më tej pagesat për këta zyrtar nuk janë në pajtim me legjislacionin. Mungesa e vlerësimit të performancës për të punësuarit, pamundëson identifikimin e fushave për përmirësim dhe zhvillimin e tyre në mënyrë efektive.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të ndërmerri veprime për të ndërprerë mbulimin e pozitave menaxheriale me UD. Kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyrë të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore. Po ashtu të siguroj që vlerësimet vjetore për të punësuarit janë kryer me kohë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe komunalitë) në vitin 2016 ishte 5,754,224€. Prej tyre ishin shpenzuar 5,718,096€, ose mbi 99%. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar 27 pagesa në vlerë 1,063,021€ si dhe katër procedura të prokurimit në vlerë 180,458€.

Testimi ynë ka nxjerr në pah disa dobësi në çështjet e paraqitura në vijim:

Çështja 7 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

E gjetura Me Ligjin për shërbyesit civil nuk lejohet lidhja e marrëveshjeve për shërbime të veçanta më gjatë se 6 muaj. Angazhimet në raste të tilla do të bëhen duke ju nënshtruar Ligjit për Detyrimet, për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Në kuadër të MD-së dhe Agjencive të saj gjatë vitit 2016 janë lidhur 27 marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Në shtatë (7) prej tyre, marrëveshjet ishin për periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj, si dhe për këto marrëveshje nuk janë udhëhequr procedurat e rekrutimit. Pagesa e tyre është bërë nga mallrat dhe shërbimet në vlerë 16,910€.

Rreziku Praktika e lidhjes së marrëveshjeve për shërbime të veçanta, pa procedura të rekrutimit, nuk siguron konkurrencë/transparencë dhe shton rrezikun për përzgjedhjen jo adekuate.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të siguroj se janë marrë veprime për të ndërprerë praktikën e angazhimeve/rekrutimeve të tilla në mungesë të procedurave në mënyrë që të evitohen pagesat e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime.

Çështja 8 – Vonesë në realizimin e pagesave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në SHKK, kemi vërejtur që tetë (8) pagesa në vlerë 290,604€ janë kryer pas afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh.
- Vonesa më e gjatë, për 104 ditë është gjetur të pagesa për furnizim me karburante për vetura në vlerë 48,565€. Ndërsa në shtatë (7) pagesat e tjera vonesat ishin nga shtatë (7) deri në 53 ditë.
- Për këtë çështje, ne kemi dhënë rekomandim edhe vitin e kaluar, mirëpo nuk ishte zbatuar. Zyrtarët e SHKK-së vonesat i kanë arsyetuar me vështirësitë për alokimin me kohë të mjeteve, si dhe me problemet me sistemin e thesarit për të realizuar pagesat.
- Rreziku** Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa të ndëshkimeve për operatorët ekonomik si dhe krijimin e obligimeve të cilat do të rendojnë buxhetin e vitit vijues.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Çështja 9 - Pranimi i mallrave para zotimit të mjeteve dhe nxjerrjes së urdhër blerjes- Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimi të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë. Në dy (2) pagesa në vërejtëm se zotimi i mjeteve dhe urdhër blerjet ishin bërë pas pranimi të faturës, si:

- Pagesa “Furnizim me ushqim” në vlerë 67,291€ më të cilën janë mbuluar nëntë (9) fatura të pranuar në muajin gusht 2016; dhe
- Pagesa “Furnizim me ushqim” në vlerë 93,210€ më të cilën janë mbuluar dhjetë (10) fatura të pranuar në muajin korrik 2016.

Sipas zyrtarëve të financave, alokimi i tretë i mjeteve ishte vonuar për një muaj e gjysmë, e që si pasojë janë vonuar në nxjerrjen e zotimeve dhe shlyerjen e obligimeve.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme do të rezultojë në vonesa të implementimit të kontratës dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues. Po ashtu mund të rezultojë që të pranohen mallra të cilësisë dhe sasisë jo të nevojshme.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë që kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 9,900€, të cilat janë shpenzuar në tërësi gjatë vitit 2016. E gjithë vlera ishte vetëm për një pagesë në kuadër të një projektit të përbashkët me Institutin e Historisë dhe Institutin Albanologjik të Kosovës.

Ne nuk vërejtëm ndonjë parregullsi në këtë proces.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale është 685,112€. Prej tyre në vitin 2016 janë shpenzuar 685,012€, ose 100% e buxhetit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar pesë (5) pagesa në vlerë 365,343€ si dhe katër (4) procedura të prokurimit në vlerë 466,550€.

MD, përkatësisht SHKK në disa projekte kapitale kishte aplikuar penale për ditët e vonesave, ndërsa në një rast kishte shkëputur kontratën.

Ne nuk vërejtëm ndonjë parregullsi në menaxhimin e shpenzimeve për investime kapitale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale dhe jo kapitale e MD-së dhe agjencive të saj ishte 98,235,145€ (pasuria me vlerë mbi 1,000€ ishte 96,279,912€, ndërsa pasuria më vlerë nën 1,000€ ishte 1,955,233€).

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF 02/2013 për menaxhimin e pasurisë qeveritare, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive. Lidhur me këtë ne testuam 37 mostra, përfshirë pasurinë mbi dhe nën vlerën 1,000€.

Bazuar në këtë konkludojmë se pasuritë nuk ishin menaxhuar në harmoni me kërkesat e përcaktuara. Dobësitë në raportimin e pasurisë i kemi paraqitur të opinionit i auditimit, te theksimi i çështjes, ndërsa dobësitë lidhur me mungesën e harmonizimit të regjistrave të pasurisë me regjistrat e dala nga procesi i inventarizimit i kemi paraqitur në vijim.

Çështja 10 - Mos përputhje i regjistrin të përgjithshëm të pasurisë me raportin e inventarizimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Në vitin 2016, MD së bashku agjencitë e saj kanë kryer procesin e inventarizimit të pasurive. Mirëpo raportet e inventarizimit nuk janë përputhur me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë. Komisionet kanë identifikuar pasuri të cilat nuk figuronin në regjistrat e sistemit e-pasuria.

Në raporte janë përshkruar numri dhe emërtimi i pasurive të cilat nuk figurojnë në regjistra. Edhe përkundër rekomandimit nga viti i kaluar MD ende nuk ka arritur të regjistroj pasuritë e saj në regjistrin e përgjithshëm të pasurisë.

Diferencat me te theksuara janë vërejtur të SHKK në mbi 11 mijë pasuri. Në raportin e inventarizimit të MD-së nuk janë përmbledhur në numër por vetëm si çështje e mos barazimit.

Mos implementimi i rekomandimit për të regjistruar pasuritë nga viti i kaluar, dëshmon një kontroll të dobët në menaxhimin e pasurive.

Rreziku Mos regjistrimi i pasurive rritë rrezikun e humbjeve dhe keqpërdorimit të tyre. Po ashtu informatat e pasakta në regjistra sjellin paqartësi në menaxhimin dhe raportimin e tyre.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohet regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit. Nëse konstatohen diferenca atëherë duhet të jepen sqarime për ndryshimet e paraqitura.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 1,032,689€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga MD-ja dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3.

Çështja 11 - Raportim jo i drejtë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne testuam mënyrën e raportimit të obligimeve të papaguara duke filluar nga protokollimi, raportimi e deri te pagesa e obligimeve dhe anasjelltas. Bazuar në këtë vërejtëm parregullsitë si në vijim:

- Katër (4) pagesa në vlerë 169,829€, nuk janë raportuar drejt në raportet mujore të obligimeve;
- SHKK në raportin e obligimeve të papaguara për muajt janar dhe shkurt 2016, ka raportuar obligime në vlerë prej 254,901€ (investime kapitale), për pjesën e punëve të pa realizuara të kontratave; dhe
- Në raportin e muajit shtator të obligimeve të papaguara, nuk janë përfshirë dy fatura në vlerë 16,118€.

Kjo kishte ndodhur pasi zyrtari përgjegjës raportonte vetëm pagesat që kalonin periudhën 30 ditë nga data e protokollit.

Rreziku Mos raportimi i saktë i obligimeve mujore rrit rrezikun që faturat të mos identifikohen dhe të mos paguhen me kohë, si dhe ekspozohet para ndëshkimeve të mundshme nga furnitorët.

Rekomandimi 11 Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të sigurojnë kontrolle shitesë në raportimin e obligimeve. Vlerat e sakta të obligimeve duhet të përcillen nga një muaj në tjetrin, në përputhje me kërkesat ligjore. Për më tepër, të gjitha masat e nevojshme duhet të merren për forcimin e kontrolleve për këto procese

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose

individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e

auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.3. Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesa më e madhe e rekomandimeve ende nuk janë zbatuar.	
2.5. Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime të menjëhershme për të nxjerrë akte nënligjore të cilat e rregullojnë organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministri.			Nuk është zbatuar.
2.5.2. Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se personi i deleguar për menaxhimin e rreziqeve siguron raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Po		
2.6. Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të siguroj një bashkëpunim të ngushtë në mes të menaxhmentit dhe NJAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe të ndërmer veprime që rekomandimet e AB-së të gjejnë zbatim në praktikë. KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces.	Po		
3.3. Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Ministri, duhet të siguroj se është bërë një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e dobët të planifikimit të buxhetit. Po ashtu, duhet siguruar se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë e detajuar e cila pasqyron në mënyrë të plotë informatat përfshirë shpenzimet e vitit të kaluar/ndryshimet e pritura të vitit, etj. Performanca e buxhetit duhet të monitorohet në baza mujore dhe të adresohen barrierat e identifikuara në ekzekutimin e niveleve të planifikuara të buxhetit me fokus të veçantë në projektet kapitale.			Nuk është zbatuar.

3.4. Prokurimi	Ministri duhet të siguroj rritjen e efikasitetit në funksionimin e kontrolleve të brendshme ekzistuese në mënyrë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme të ndara për pagesën e tyre.			Nuk është zbatuar.
3.4. Prokurimi	Ministri në bashkëpunim me personat përgjegjës duhet të siguroj mbikëqyrje të rregullt të procesit të realizimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.			Nuk është zbatuar.
3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të zhvlerësimit. Në rast nevoje zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.			Nuk është zbatuar.
3.7.1. Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e pasurisë. Në fund të çdo viti pas procesit të inventarizimit, duhet të harmonizohen regjistri i përgjithshëm i pasurisë me regjistrin e nxjerrë në procesin e inventarizimit. Nëse konstatohen diferenca atëherë duhet të jepen sqarime për ndryshimet e paraqitura.			Nuk është zbatuar.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

R.R.



Rrahmi Kama
U.D. Sekretar i Përgjithshëm
Data: 25 prill 2017, Prishtinë